



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

LEGJISLATURA VIII

Sesioni pranveror

Komisioni për Mjedis, Ushqim, Bujqësi, Planifikim dhe Zhvillim

Mbledhja nr. 86

Prishtinë, më 28.5.2024, në orën 13:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla C-203

PROCESVERBAL

Në mbledhje morën pjesë: Fitore Pacolli-Dalipi, Besian Mustafa, Milazim Salijaj, Isak Shabani, Ekrem Mustafa, Samra Ilijazi, Jetmire Vrenezi dhe Albena Reshitaj.

Munguan: Salih Zyba dhe Ganimete Musliu.

Pjesëmarrës të tjerë: Shqipe Pajaziti nga Kosova Press dhe KDI

Stafi mbështetës i Komisionit: Ylber Sherifi.

Mbledhjen e kryesoi **Fitore Pacolli-Dalipi, kryetare e Komisionit.**

Në këtë mbledhje u propozua ky :

Rend i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e dt. 14.5.2024;
3. Shqyrtimi në parim i Projektligjit 08/L-305 për ofruesin e shërbimeve të navigacionit ajror;
4. Shqyrtimi i Projektligjit 08/L-275 për rrugët;
5. Shqyrtimi i Projektligjit 08/L-241 për Vlerësimin Strategjik Mjedisor;
6. Të ndryshme.

1. Miratimi i rendit të ditës

Në fillimi deputetja *Jetmire Vrenezi*, kryesuese e grupit të punës për Projektligjin nr. 08/L-241 për Vlerësimin Strategjik Mjedisor, kërkoi që pika e 5 e rendit të ditës: “Shqyrtimi i Projektligjit 08/L-241 për Vlerësimin Strategjik Mjedisor” të shtyhet për një mbledhje tjetër pasi që nga Ministria e mjedisit kanë ardhë edhe disa komente shtesë që duhet me i shqyrtua. Pastaj, *Komisioni, me 6 vota për, asnjë kundër dhe asnjë abstenim, e miratoi këtë propozim.*

Ndërsa, me 7 vota për, asnjë kundër dhe asnjë abstenim, komisioni e miratoi rendin e ditës me këtë ndryshim.

2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e dt. 14.5.2024

Komisioni, me 7 vota për, asnjë kundër dhe 1 abstenim, e miratoi procesverbalin nga dt. 14.5.2024

3. Shqyrtimi në parim i Projektligjit 08/L-305 për ofruesin e shërbimeve të navigacionit ajror

Kryetarja e paraqiti për shqyrtim projektligjin dhe tha se ky Projektligj i ka 30 Nene dhe ka për qëllim të rregullojë statusin, mënyrën e organizmit, kompetencat e Ofruesit për Shërbimet e Navigacionit Ajror, si subjekt i pavarur juridik shtetëror në shërbim të interesit publik, për të siguruar infrastrukturën dhe shërbimet e navigacionit ajror në hapësirën ajrore të Republikës së Kosovës.

Pastaj shtoi se sipas opinionit për vlerësimin e ndikimit buxhetor nga Ministria e Financave, projektligji nuk do të ketë kosto shtese buxhetore. Ndërsa sipas opinionit ligjor të përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së, Projektligji është ë përputhje me të gjitha Rregulloret dhe Direktivat e BE-së që ndërlidhen me shërbimet e navigacionit ajror të trasnpozuara përmes akteve nënligjore nga Autoriteti i Aviacionit Civil siç e obligon Marrëveshja shumëpalëshe për themelimin e hapësirës së përbashkët Evropiane të Aviacionit. Projektligji i plotëson kushtet e parapara në nenin 71 të Rregullores së Kuvendit.

Pasi që nuk pati diskutues, kryetarja i ftoi deputetët për votim dhe konstatoi se me 6 vota për, asnjë kundër dhe 1 abstenim, Komisioni vendosi që Kuvendit t'ia paraqesë këtë

Rekomandim:

Të miratohet në parim Projektligji nr. 08/L-305 për ofruesin e shërbimeve të navigacionit ajror

4. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 08/L-275 për rrugët

Kryetarja, tha se komisioni ka formuar grupin e punës për këtë Projektligj, i cili ka përgatitë raportin me amendamente për komisionin dhe e ftoi kryesuesin e këtij grupi deputetin *Milazim Salijaj*, ta paraqet raportin me amendamente.

Milazim Salijaj, tha se Grupi i punës për Projektligjin nr.08/L-275 për rrugët, është formuar me 2.4.2024 në këtë përbërje: *Milazim Salijaj*-kryesues, *Ekrem Mustafa*, *Isak Shabani* dhe *Jetmire Vrenezi*-anëtarë. Grupi punues ka mbajtur 8 mbledhje ku bashkë me përfaqësuesit e MMPHI-së sponsor të projektligjit e ka shqyrtu dhe amendamentu projektligjin. Grupi i punës e ka përgatitë raportin me 95 amendamente për komisionin dhe të cilat i ftoj ti votojnë dhe të procedohen për komisionet e përhershme.

Isak Shabani, pyeti nëse është harmonizuar përkufizimi “Autoudhë “ dhe “Autostradë” pasi që në Ligjin për rregullat e trafikut ka mbetë autostradë ndërsa këtu autoudhë?

Milazim Salijaj, tha se është diskutuar kjo në grup punues dhe ka mbetë në këtë ligj termi Autoudhë si term më përmbajtësor dhe e lexoi atë:

“Autoudhë” - rrugë publike e projektuar dhe ndërtuar posaçërisht për trafikun e mjeteve motorike e cila nuk i shërben pronave për rreth kufijve të saj dhe e cila është e shënuar me shenjë të posaçme të trafikut, ka dy shirita rrugor të ndarë fizikisht për lëvizje me kahje të kundërta. Shiriti rrugor duhet t'i ketë së paku dy shirita të trafikut me nga një shirit për ndalje emergjente në të dy anët e auto udhës. Rrugët e njejeve te autoudhës janë pjesë e autoudhës.”

Kryetarja, pasi që nuk kishte diskutues, i ftoi deputetët për votim të raportit me 95 amendamente dhe konstatoi se me 6 vota për, asnjë kundër dhe 1 abstenim, Komisioni nxori këtë:

Përfundim

- 1. Miratohen amendamentet e Grupit të punës për Projektligjin nr. 08/L-275 për rrugët.*
- 2. Raporti me amendamente të procedohet te komisionet e përhershme, sipas procedurës.*

5. Të ndryshme.

Fitore Pacolli-Dalipi, kryetare, tha se Projektligji nr. 08/L-268 për shpronësimin e pronës se paluajtshme ka kaluar në leximin e parë në seancën e datës 23.5.2024 dhe i ftoi t'i propozojnë emrat për grupin punues. Pas propozimeve, ajo konstatoi se Komisioni e formoi grupin punues në këtë përbërje: Milazim Salijaj- kryesues, Besian Mustafa, Albena Reshitaj, Ekrem Mustafa Jetmire Vrenezi dhe Fitore Pacolli-Dalipi -anëtarë.

Kryetarja për punëtorinë që do të mbahet, për shqyrtimin e Projektligjit për administrimin e ndërtesave dhe lagjeve të banimit në bashkëpronësi, kërkoi nga deputetët që për shkak të organizimit ta konfirmojnë paraprakisht pjesëmarrjen.

Mbledhja përfundoi në orën 13:30.

E përgatiti: Stafi mbështetës i Komisionit

Fitore Pacolli-Dalipi,

Kryetare e Komisionit